Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave*

# RrGGK lanson Strategjinë e re 2015-2018 dhe shfaq Dokumentarin për Fondin e Grave të Kosovës

*E enjte, 20 nëntor 2014,*
*10:45 – 13:00, Hotel Grand, Prishtinë*

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) do të bëjë lansimin e Strategjisë 2015-2018, të Enjten me 20 nëntor 2014, nga ora 10:45 deri 13:00 në Hotel Grand, Prishtinë.

Strategjia e re e RrGGK është përpiluar nga anëtaret e RrGGK-së, Bordi i Drejtorëve, partnerët kyç dhe palët e interesuara dhe përfshin pesë fusha programatike të identifikuara si prioritete nga anëtaret e RrGGK:

- Ngritja e Kapacitetit të Programit të RrGGK;
- Gratë në Politikë dhe Vendim-marrje;
- Të Drejtat e Grave në Kujdesin Shëndetësor;
- Programi kundër Dhuës në Baza Gjinore; dhe
- Fuqizimi Ekonomik i Grave.

Gjithashtu, në këtë event, RrGGK për herë të parë do të shfaq dokumentarin për Fondin e Grave të Kosovës, i cili u themelua në vitin 2012 për të kontribuar në aktivitetet që organizojnë anëtaret e RrGGK.

Për detaje më të hollësishme, të bashkangjitur e gjeni agjendën.

PRESS

*www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000 Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 • info@womensnetwork.org*